

VENDIM
Nr. 739, datë 12.12.2025

**PËR NGARKIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT, SI AUTORITET
KONTRAKTOR, PËR KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT PUBLIK,
PËR RIKONSTRUKSIONIN E MJEDISEVE TË KATIT NËNTOKËSOR TË
NDËRTESES SË KRYEMINISTRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si autoritet kontraktor dhe njësi zbatuese, për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për projektimin dhe kryerjen e punimeve të zbatimit për rikonstruksionin e transformimin e mjediseve të dëmtuara në hapësira funksionale në katin nëntokësor të ndërtesës së Kryeministrisë.

2. Në funksion të zbatimit të projektit, të përcaktuar në pikën 1, Fondi Shqiptar i Zhvillimit ngarkohet të kryejë:

a) të gjitha procedurat, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, duke lidhur edhe kontratën përkatëse, si dhe të ndjekë zbatimin e saj e të projektit përkatës;

b) paraqitjen, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, të kërkesave për miratimin e lejeve përkatëse, në funksion të zbatimit të punimeve.

3. Kryeministria i vendos në dispozicion Fondit Shqiptar të Zhvillimit të dhënat për specifikimet teknike të projektit.

4. Efektet financiare të përballohen nga fondet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

5. Ngarkohen Kryeministria dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama